



KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 52, dt. 02.04.2015

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “*Për Trashëgiminë Kulturore*”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 02.04.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të projektit “Rikonstruksioni i Teatrit të Kukullave”, Tiranë.
Në objekt të ndërhyhet vetëm për punime emergjente dhe të mirëmbajtjes.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI